



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKISË KORÇE**

VENDIM

Nr. 88 date 18.09.08

Per strehimin e familjeve qe banojne ne mjediset e "Ish Repartit 741"

Keshilli i Bashkise Korce pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike dhe bazuar në nenin 32 te ligjit 8652, date 31.07.2000 "Per Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", ligjin Nr 9232 date 13.05.2004 "Per Programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urban" si dhe V.K.M Nr 726 datë 28.05.2008 "Për transferimin ne pronësi ,nga Ministria e Brendshme ,Bashkisë Korçe,të objektit 'Ish Reparti 741 ' dhe për një ndryshim ne Vendimin Nr.250 datë 24.03.2003 te Këshillit te Ministrave 'Për miratimin e listës se inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore,te cilat i kalojnë ne përgjegjësi administrimi Ministrisë se Rendit Publik", si dhe mbas diskutimeve te Keshilltareve

VENDOSI

1. Te strehoje familjet qe banojne ne mjediset e "Ish Repartit 741"
2. Te ngarkohet ekzekutivi te paraqese per miratim ne Keshillin Bashkiak listen e familjeve qe do te streohen.
3. Te ngarkohet ekzekutivi te propozoje programet per strehimin e banoreve si dhe percaktoje masen e subvencionimit per cdo familje.
4. Keto familje duhet te jene te pajisur me autorizim nga Ministria e Brendshme, te banojne aktualisht ne mjediset e "Ish Repartit 741" dhe te plotesojne deklaraten pranë Bashkisë Korçe ,qe pranojnë te pajisen me banese dhe do ti nënshtrohen te gjitha dispozitave te ligjit Nr 9232 date 13.05.2004 "Per Programet sociale per strehimin e banoreve te zonave urban" dhe akteve ligjore ne zbatim te tij .
5. Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Perkrahes Sociale dhe Strehimit (Sektori i Administrimit te Nevojave per Strehim) dhe Drejtoria Juridike
6. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

KRYETARI

Rajmonda NASE

Rajmonda Nase